



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 715 Prot.

Tiranë, më datë 14.05.2021

VENDIM
Nr. 253, datë 14.05.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 14.05.2021:

VENDOSI:

1. Të mos miratojë konceptin e sondazheve arkeologjike të realizuara nga person i licencuar në arkeologji z. Dhimitër Çondi, në kuadër të projektit “Banesë vertikale dy kate me podrum”, rruga “Burimi i thatë”, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “B” të Parkut Arkeologjik Finiq, me aplikues Aristotel Koçi dhe zhvillues Lefter Spiro, për shkak se subjekti ka kryer punime gërmimi të gjurmës së projektit para shqyrtimit të tij në organet kompetente;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

